



Periodik mujor Nr. 175 Dhjetor 2023

**Në
këtë
periodik
do të lexoni:**

**AMF nxjerr për konsultim publik
projektrregulloret bazuar në Ligjin
“Për Fondet e Pensionit Privat”**

**VËSHTRIM
MBI TREGJET**

Tregu i Sigurimeve, Janar - Nëntor 2023

4

ZHVILLIME TË TJERA

**BOTIME
PROFESIONALE**

5 - 14

**INFORMACIONE
NDËRKOMBËTARE**

15-17

AMF nxjerr për konsultim publik projektregulloret bazuar në Ligjin “Për Fondet e Pensionit Privat”



Projektregulloret publikohen në faqen zyrtare të Autoritetit, për konsultim publik

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në zbatim të Ligjit nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”, ka hartuar projektregulloret:

- “Për përcaktimin e elementëve të kontratës së anëtarësimit, të deklaratës së pranimit të pjesëmarrjes, të kontratës së administrimit të aktiveve të shoqërisë administruese dhe përbajtjes dhe strukturës së prospektit të fondit”; dhe
- “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërisë administruese të fondeve të pensionit privat dhe depozitarit të fondeve të pensionit privat të themeluara në Republikën e Shqipërisë”.

Projektregulloret e sipërpërmendura dhe shtojcat përkatëse publikohen në faqen zyrtare të Autoritetit, për konsultim publik. Klikoni më poshtë:

- [Projektregullore “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërisë administruese të fondeve të pensionit privat dhe depozitarit të fondeve të pensionit privat të themeluara në Republikën e Shqipërisë”.](#)
- [Projektregullore “Për përcaktimin e elementëve të kontratës së anëtarësimit, të deklaratës së pranimit të pjesëmarrjes, të kontratës së administrimit të aktiveve të shoqërisë administruese dhe përbajtjes dhe strukturës së prospektit të fondit”](#)

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, Janar-Nëntor 2023


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar-nëntor 2023 kapën vlerën 20,521 milionë lekë, ose 8.38% më shumë se në janar-nëntor 2022. Gjatë periudhës janar-nëntor 2023, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 1,322,512 me një rritje prej 10.84% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 91.94% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, sigurimet e Jetës kanë 8.00% dhe risigurimi 0.059 %. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 39.04% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 60.96% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-nëntor 2023, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 6,338 milionë lekë, ose 3.22% më shumë se në periudhën janar-nëntor 2022.

Dëmet e paguara bruto në sigurimin e motorik për periudhën janar-nëntor 2023 kapën vlerën 4,386 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 9.93% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Struktura e tregut të sigurimeve, Janar-Nëntor 2023 (Në %)



Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik, gjatë periudhës janar-nëntor 2023 arritën rreth 12,510 milionë lekë, ose 6.96% më shumë se në periudhën janar-nëntor 2022.

Raporti i Tregut Global të Sigurimeve IAIS 2023 thekson rreziqet dhe tendencat kryesore me të cilat përballet sektori global i sigurimeve



(Marrë me shkurtime dhe e redaktuar)

Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) publikoi më 6 dhjetor 2023 Raportin e saj të Tregut Global të Sigurimeve 2023 (GIMAR). Disa nga gjetjet kryesore janë:


- Rezultatet agregate të rrezikut sistemik në sektorin e sigurimeve në nivel global ranë në krahasim me vitin e kaluar, duke mbetur shumë më poshtë se këto tregues për bankat.
- Raporti jep një analizë të gjerë të kryer mbi dy tema kryesore: (i) normat e interesit, likuiditeti dhe rreziqet e kreditit në një mjedis makroekonomik sfidues; dhe (ii) ndryshimet strukturore në sektorin e sigurimit të Jetës, duke përfshirë shpërndarjen më të madhe të kapitalit për aktivet alternative dhe rritjen e mbështetjes në risigurimin ndërkufitar të aktiveve. Raporti jep edhe një pasqyrë të përgjithshme të aftësisë paguese, përfitueshmërisë dhe likuiditetit të siguresve.
- Siguresit vazhdojnë të kenë ekspozime materiale ndaj ndryshimeve klimatike, nëpërmjet investimeve të tyre të rëndësishme në “sektorë të lidhur me klimën”, dhe nëpërmjet rritjes së pritshme të dëmeve në lidhje me ngjarjet e katastrofës natyrore (NatCat), të cilat mund të ndikojnë në përfitimin dhe mjaftueshmërinë e kapitalit.
- Duke shikuar në perspektivë, aftësia paguese dhe përfitimi i siguresve mund të ndikohen negativisht nga gabimet, humbjet e porealizuara dhe ulja e kërkesës për sigurime për shkak të tendosjeve të fuqisë blerëse të familjeve në disa tregje. Tensionet gjeopolitike vazhdojnë të ndikojnë negativisht në vështrimin tërësor të sektorit.

Materiali është publikuar në:

<https://www.iaisweb.org/uploads/2023/12/Global-Insurance-Market-Report-2023.pdf>

Raporti i Tregut Global të Sigurimeve IAIS 2023 thekson rreziqet dhe tendencat kryesore me të cilat përballlet sektori global i sigurimeve

... Vijon



Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) publikoi më 6 dhjetor 2023 Raportin e saj të Tregut Global të Sigurimeve 2023 (GIMAR), duke përcjellë rezultatet e Ushtrimit të Monitorimit Global të këtij viti (GME), si kuadri për vlerësimin e rrezikut dhe monitorimit për rreziqet dhe tendencat kryesore, si edhe për zbulimin e rrezikut të mundshëm sistemik në sektorin global të sigurimeve.

Ushtrimi i Monitorimit Global, GME, bazohet në të dhënat e mbledhura deri në fund të vitit 2022 nga 60 grupet më të mëdha ndërkombëtare të sigurimeve si edhe të dhënat agregate për të gjithë sektorin nga mbikëqyrësit në të gjithë globin, duke mbuluar mbi 90% të primeve të shkruara në nivel global.

“Të dhënat e GME tregojnë se mjaftueshmëria e kapitalit të sektorit të sigurimeve globale mbetet e shëndoshë, por ka rënë paksa në fund të vitit 2022, kryesisht për shkak të zhvillimeve të tregut financiar, siç janë vlerësimet më të ulëta të aktiveve,” tha Shigeru Ariizumi, Kryetar i Komitetit Ekzekutiv të IAIS. “Megjithatë, gjurma agregate e rrezikut sistemik për sektorin e sigurimeve u ul në fund të vitit 2022, krahasuar me një vit më parë.”

Elementët kryesorë për rënien e rezultateve të rrezikut sistemik për sektorin e sigurimeve janë ekspozimet më të ulëta ndaj financimit afatshkurtër, likuiditeti i detyrimeve, aktivet ndërfinanciare dhe garancitë minimale për produktet e ndryshueshme. Një krahasim ndërsektorial i pikëve të rrezikut sistemik të sigurimeve me sektorin bankar tregon se rreziku sistemik që rrjedh nga siguresit mbetet dukshëm më i ulët se ai i bankave.

Materiali është publikuar në:

<https://www.iaisweb.org/uploads/2023/12/Global-Insurance-Market-Report-2023.pdf>

IOSCO finalizon Rekomandimet e Politikave të saj për Financat e Decentralizuara



Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë, IOSCO ka publikuar raportin përfundimtar me Rekomandimet e Politikave të saj për Financat e Decentralizuara (DeFi). Nëntë Rekomandimet e Politikave synojnë të adresojnë shqetësimet për integritetin e tregut dhe mbrojtjen e investitorëve që dalin nga DeFi duke mbështetur një qëndrueshmëri më të madhe të kornizave rregulatore dhe mbikëqyrëse në juridiksionet anëtare të kësaj organizate.

Rekomandimet mbulojnë gjashtë fusha kryesore:

- Kuptimi i organizimeve dhe strukturave të DeFi;
- Arritja e standardeve të përbashkëta të rezultateve rregullatorë;
- Identifikimi dhe menaxhimi i rreziqeve kryesore;
- Dhënia e informacioneve shpjeguese të qarta, të sakta dhe gjithëpërfshirëse;
- Zbatueshmëria e ligjeve që aplikohen; dhe
- Bashkëpunimi ndërkufitar.

Rekomandimet e Politikave të DeFi janë plotësuese me Rekomandimet e Politikave për Tregjet e Aktiveve Kripto dhe Dixhitale (CDA) të publikuara në nëntor 2023. Dy grupet e rekomandimeve të IOSCO-s janë zhvilluar në përputhje me Udhërrëfyesin e IOSCO-s 2022/2023 të Kripto-Aseteve. Ndërveprimi midis këtyre dy grupeve të rekomandimeve është detajuar në "Shënimin Përmbledhës" (*Umbrella Note*), i cili është publikuar së bashku me Raportin Përfundimtar të DeFi.

Me publikimin e këtyre rekomandimeve, IOSCO tani po e zhvendos vëmendjen drejt monitorimit të zbatimit, ndërtimit të kapaciteteve dhe nevojave për asistencë teknike të anëtarëve të saj.

Vijon ...

Materiali i publikuar gjendet <https://www.iosco.org/news/pdf/IOSCONEWS720.pdf>

IOSCO finalizon Rekomandimet e Politikave të saj për Financat e Decentralizuara



... Vijon

IOSCO e njeh faktin se juridiksionet (rregullatorët nga vende të ndryshme anëtare) janë në faza të ndryshme të trajtimit të rreziqeve të paraqitura nga tregjet e kripto-aseteve dhe financat e decentralizuara. Disa kanë regjime ekzistuese, ndërsa të tjerët duhet të zhvillojnë korniza të reja, të personalizuara.

Jean-Paul Servais, Kryetar i IOSCO-s theksoi ndër të tjera se rreziqet e tregjeve të kripto-aseteve janë reale dhe jemi duke i trajtuar këto në mënyrë të koordinuar, duke kërkuar zbatimin e qëndrueshëm të këtyre rekomandimeve të IOSCO-s nga të gjithë anëtarët për të mbrojtur globalisht dhe më së miri investitorët.

Tuang Lee Lim, Kryetar i Task - Forcës Fintech të Bordit të IOSCO-s, i krijuar për të zhvilluar politikën në këtë drejtim, theksoi se dy grupet e rekomandimeve për CDA dhe DeFi ofrojnë një kuadër koherent dhe të fuqishëm të politikave për të trajtuar rreziqet thelbësore të paraqitura nga tregjet e kripto-aseteve. Kjo do të ndihmojë në krijimin e një fushë loje të drejtë dhe transparente, ku mund të zhvillohet inovacioni i përgjegjshëm, që siguron njëkohësisht edhe mbrojtjen e investitorëve e integritetin e tregut.

Materiali i publikuar gjendet

<https://www.iosco.org/news/pdf/IOSCONEW5720.pdf>

INFORMACIONE NDËRKOMBËTARE

ÇEKI

www.xprimm.com

Sipas shifrave tremujore të Shoqatës Çeke të Sigurimeve, në fund të shtatorit 2023, vëllimi i primeve të shkruara bruto, i raportuar nga kompanitë anëtare arriti në 127 miliardë CZK ose rreth 5.2 miliardë euro, duke shënuar një rritje prej 6.5% më shumë se një vit më parë.

Sigurimi i Jetës përbën 30% të vëllimit total të primeve të shkruara bruto me rreth 38.2 miliardë CZK dhe rritje 2.3% krahasuar me 9-mujorin e vitit të kaluar. Pjesa tjetër prej 70% e primeve bruto i përket sigurimeve të Jo-Jetës. Sigurimet e Jo-Jetës në vlerë arritën në 88.8 miliardë CZK, me rritje 8.5% më shumë se një vit më parë. Vëllimin më të madh të primeve në sigurimin e Jo-Jetës e zënë sigurimet MTPL me 18.37% totalit të primeve të shkruara bruto, sigurimi Kasko me 18.35% dhe sigurimi i pronës dhe përgjegjësisë me 10.4%.

GREQI

www.xprimm.com

Shifrat paraprake të tregut të sigurimeve për tremujorin e tretë 2023, të publikuara nga HAIC - Shoqata Helenike e Shoqërive të Sigurimeve, tregojnë se në fund të shtatorit 2023, tregu grek i sigurimeve arriti në 3.8 miliardë euro, duke u rritur me 9.7% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Segmenti i sigurimeve të Jo-Jetës u rrit me 11% duke arritur në 2 miliardë euro, nga të cilat 557 milionë euro ishin sigurimi MTPL, 209 milionë euro ishin sigurimi Kasko, 394 milionë euro ishin sigurimi i pasurisë/ pronës. Segmenti i sigurimit të Jetës u rrit me 8.4% duke arritur në 1.8 miliardë euro, kryesisht për shkak të rritjes prej 9.2% të produkteve të sigurimit të Jetës të lidhura me skemat e kursimeve (UL).

Shifrat e tregut të publikuara nga HAIC, për tremujorin e tretë 2023, përfshijnë informacionin për 49 sigurues, nga të cilët 43 ishin aktivë në sigurimet e Jo-Jetës dhe 15 në sigurimet e Jetës.

HUNGARI

www.xprimm.com

Sipas statistikave tremujore të publikuara nga Banka Qendrore e Hungarisë, në fund të tremujorit të tretë 2023, vëllimi i primeve të shkruara bruto për siguruesit hungarezë arriti në vlerën e 1,148 miliardë HUF, afërsisht rreth 2.9 miliardë euro, duke u rritur me 4.1% në vit. Gjatë kësaj periudhe, segmenti i sigurimit të Jetës përbën 37.4% dhe segmenti i sigurimeve të Jo-Jetës zinte 62.6% të totalit të primeve të shkruara bruto.

Në fund të shtatorit 2023, në tregun hungarez të sigurimeve ishin aktive 22 sigurues, nga të cilët 4 sigurues të specializuar në sigurimet e Jetës, 9 sigurues të Jo-Jetës dhe 9 sigurues të cilët mbulonin të dy segmentet e tregut.

MAQEDONIA E VERIUT

www.xprimm.com

Sipas shifrave paraprake të tregut të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë së Veriut për nëntëmujorin 2023, siguruesit në vend raportuan një vlerë të primeve të shkruara bruto 10.8 miliardë denarë ose rreth 176 milionë euro, duke realizuar kështu 12.8% më shumë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto në sigurimet e Jo-Jetës përbën rreth 84.3% të vëllimit total të primeve me rreth 9.1 miliardë denarë, ose 148.3 milionë euro. Kjo shifër është 13.5% më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë. Klasat me peshën më të madhe në vëllimin e primeve janë MTPL e cila zë 39.2% e totalit, prona me 17.3%, dhe sigurimi Kasko me 8.1%. Sigurimi i Jetës zë rreth 15.7% të totalit të tregut. E shprehur në vlerë absolute arrin rreth 1.7 miliardë denarë ose 27.7 milionë euro, me rritje prej 9.3% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Rritje kishte edhe vlera e dëmeve të paguara për nëntëmujorin e 2023. Dëmet e paguara në sigurimin e Jetës u rritën me 24.5% në terma vjetorë duke arritur në 603.5 milionë denarë ose rreth 9.8 milionë euro. Ndërsa dëmet për sigurimet e Jo-Jetës arritën në fund të shtatorit 2023 rreth 3.5 miliardë denarë ose rreth 57.4 milionë euro, duke u rritur me 183% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

POLONI

www.xprimm.com

Sipas statistikave tremujore të publikuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Polonisë, KNF, tregu në vend shënoi një vëllim të primeve të shkruara bruto për nëntëmujorin e vitit 2023 me vlerë 57.7 miliardë PLN, ose 12.5 miliardë euro. Kjo shifër shënon një rritje me 9.4% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Dëmet e paguara nga siguruesit vendas u ulën me rreth 1.6% në vit duke arritur në 33 miliardë PLN ose 7.1 miliardë euro.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto të sigurimit të Jetës u rrit me 7.2% në vit, duke arritur në mbi 17 miliardë PLN ose rreth 3.7 miliardë euro. Segmenti i sigurimit të Jo-Jetës u rrit me 10.3%, duke arritur në 40.6 miliardë PLN ose rreth 8.8 miliardë euro.

QIPRO

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të publikuara nga Shoqata e Sigurimeve të Qipros, IAC, tregu i sigurimeve në vend, në fund të shtatorit 2023 arriti në 870 milionë euro, duke u rritur me 13.6% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto në sigurimet e Jetës u rrit me 18.5% në terma vjetorë, duke arritur në 443.5 milionë euro. Vëllimi i primeve të shkruara bruto në sigurimet e Jo-Jetës pati një rritje prej 9%, duke arritur në 426.5 milionë euro.

Vlera e dëmeve të paguara nga siguruesit vendas në sigurimet e Jetës arriti në 186.5 milionë euro, me rritje 14% më shumë se nëntëmujorin e vitit të kaluar. Ndërsa dëmet e paguara bruto në sigurimin e Jo-Jetës (duke përfshirë edhe pagesat e fondit rezervë të dëmeve) u rritën me 12.7% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke arritur në 191 milionë euro.

SLLOVAKI

www.xprimm.com

Sipas statistikave të publikuara nga Shoqata Sllovaqe e Sigurimeve, SLASPO, në fund të tremujorit të tretë, vëllimi i primeve të shkruara bruto nga anëtarët e shoqatës arriti në 2.04 miliardë euro, duke u rritur me 4.78% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u rritën me 2.67% në vit duke arritur në 792.65 milionë euro, pavarësisht rënies me mbi 10% në sigurimet e Jetës të indeksuara dhe të lidhura me skemat e investimeve. Ndërsa segmenti i sigurimeve të Jo-Jetës u rrit me 6.17% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke arritur në 1.25 miliardë euro.

UKRAINË

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të publikuara nga Banka Kombëtare e Ukrainës, NBU, tregu i sigurimeve në vend për periudhën janar-shtator 2023 regjistroi një rritje të primeve të shkruara bruto prej 19.49% duke arritur vlerën e 34.14 miliardë UAH, ose 885.55 milionë euro. Rreth 90% e portofolit të tregut u gjenerua nga sigurimet e Jo-Jetës, ndërsa sigurimet e Jetës sollën vetëm 3.56 miliardë UAH gjatë 9-mujorit 2023. Numri i kontratave të sigurimit të lidhura për periudhën janar-shtator 2023 arriti në 73.35 milionë kontrata.

Dëmet e paguara për 9-mujorin 2023 arritën në 12 miliardë UAH, ose rreth 311.96 milionë euro, nga të cilat 6.5 miliardë UAH u paguan për individët. Peshën më të madhe në dëmet e paguara e zënë sigurimi Kasko dhe MTPL.

Sipas Bankës Kombëtare të Ukrainës, në tregun e sigurimeve në vend kanë mbetur 99 sigurues të Jo-Jetës (rreth 50 kompani janë aktive në treg - me dëme të paguara mbi 1 milion UAH) dhe 12 sigurues të Jetës (8 kompani janë aktive në treg).



Për informacion të mëtejshëm
na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al